



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 13, Datë 16.01.2025

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUNNY SIDE ENERGY” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË
E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38 pika 1, gërma “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14, pika 9, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.01.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 116 prot., datë 14.01.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2442 prot., datë 25.11.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 100 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 1451, Fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 270, datë 10.12.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 11.12.2024 dhe 12.12.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 09.01.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të ERE-s.
- Me shkresën nr. 2442/4 prot., datë 13.12.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, duke kërkuar gjithashtu që të shprehet nëse ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e kontratës së paraqitur në kuadër të këtij aplikimi dhe të drejtën e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Deri në këtë vendimmarrje, nga MIE nuk ka pasur asnjë përgjigje.

- Me shkresën nr. 2442/3 prot., datë 13.12.2024, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim dhe i ka kërkuar plotësimin e informacionit/dokumentacionit të konstatuar të munguar.
- Shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues me shkresën nr. 2442/5 prot., datë 24.12.2024.
- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a” “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”; dhe për pikën 2.1 gërmat “a”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Rezulton se shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k.:
 - Ka depozituar Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 673, datë 30.10.2024, “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë fotovoltaik dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesionit, në zonën kadastrale 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Qarku Fier, nga shoqëria “Sunny Side Energy sh.p.k.”;
 - Ka nënshkruar me MIE-n, Kontratën nr. 1192 rep., nr. 482 kol., datë 11.11.2024 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaik, me kapacitet prodhues 100 MW, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Zonën Kadastrale nr. 1451, Fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “SUNNY SIDE ENERGY”;
 - Ka depozituar shkresën e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a., nr. 2152/3 prot., datë 26.04.2023, me anë të së cilës është miratuar në parim lidhja e Parkut Fotovoltaik Sunny Side Solar, me rrjetin e transmetimit.
 - Është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më datë 21.03.2024 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i impiantit fotovoltaik “Sunny Side Solar Park”, me fuqi 100 MW. Kjo VNM është e vlefshme deri më 21.03.2026.
- Në nenin 4 të kontratës së nënshkruar me MIE-n, nr. 1192 rep., nr. 482 kol., datë 11.11.2024, specifikohet se kontrata lidhet për një afat 49-vjeçar, nga data e hyrjes në fuqi të saj, me të drejtë ripërsëritjeje. ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka depozituar garancinë 30-vjeçare për panelet fotovoltaike, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet që të jetë për 30 vjet.
- Në kushtet që shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k., sipas shkresës së OST sh.a., nr. 2152/3 prot., datë 26.04.2023, i është miratuar në parim lidhja e Parkut Fotovoltaik Sunny Side Solar, vlerësohet që t’i lihet kusht që të depozitohet në ERE miratimin përfundimtar të pikës së lidhjes/marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a., përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 9 të Kontratës nr. 1192 rep., nr. 482 kol., datë 11.11.2024, të nënshkruar me MIE-n, shoqëria duhet të pajiset me lejet përkatëse, të ndërtojë dhe vendosë në operim centralin brenda datës 30.10.2027, ndaj vlerësohet t'i lihet kusht shoqërisë që të fillojë operimin e centralit dhe ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda këtij afati.
- Rezulton se shoqëria ka një VNM të vlefshme (deri më 21.03.2026), ndaj vlerësohet që në kuadër të mbikëqyrjes, shoqëria të raportojë çdo 3 (tre) muaj në ERE në lidhje me fillimin e punimeve brenda këtij afati.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet prodhues 100 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 1451, Fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.
2. Përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, shoqëria duhet të depozitojë në ERE, marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e transmetimit.
3. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 30.10.2027.
4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në varësi të plotësimit të kushteve të vendosura në pikën 2 dhe 3.
5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OST” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI